



BULETINI MUJOR

KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM

KRYETARI AHMETI PREZANTOI RAPORTIN VJETOR TË PUNËS



Kryetari ka falenderuar të gjithë qytetarët e Lipjanit dhe partnerët vendor e ndërkombëtar, për kontributet e përbashkëta gjatë vitit që lamë pas si dhe i ka ftuar të gjithë që të angazhohen së bashku në tejkalimin e sfidave dhe vështirësive, në dobi të progresit të gjithanshëm si dhe zhvillimin shumëdimensional të komunës sonë.



Marrëveshje bashkëpunimi në mes Komunës së Lipjanit dhe IADK




Kryetari Imri Ahmeti së bashku me drejtorin e IADK Zenel Bunjaku, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për bashkëfinancimin dhe zbatimin e projektit “Fuqizimi i të rinjve dhe grave të zonave rurale për përfshirje në bujqësi dhe përpunim të ushqimit”.

Nga projekti i cili do të implementohet në vitin 2021, në bazë kesaj marreveshje do të organizohen trajnime për gra dhe të rinjë të Komunës së Lipjanit, ku kandidatet më të suksesshme do të përkrhahen me mjete financiare për konkretizimin e ideve të tyre.



Ka filluar ndërtimi i objektit shtesë të shkollës “Vëllëzërit Frasheri” në Lipjan

Kryetari i Komunës, Imri Ahmeti së bashku me bashkëpunëtorë kanë vendosur gurthemelin e objektit shtesë të shkollës “Vëllëzërit Frasheri”, në Lipjan.



Ndërtimi i objektit shtesë të shkollës “Vëllëzërit Frasheri” në Lipjan


Fillimi i ndërtimit të këtij objekti shkollor është mirëpritur nga nxënësit dhe mësimmdhënësit. Kryetari Imri Ahmeti tha se ndërtimi i këtij objekti shkollor bëhet me financimin e komunës së Lipjanit, ky objekt do të krijoj mundësi të reja pasi shkolla e tanishme është ngarkuar me numër të madh të nxënësve, ne do të përkushtohemi që me 1 shtator të përrurohet ky objekt i ri shkollor.

Biblioteka e qytetit është pasuruar me mbi 200 tituj të rinj



Në Bibliotekën e qytetit në Lipjan është pranuar një donacion me 210 tituj të rinj të librave me gjithsejtë 303 ekzemplarë, donacion nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës.

Anila Reçica-Llugiqi, drejtoresh për Kulturë Rini dhe Sport, ka thënë se ky donacion është i rëndësishëm sepse dita ditës Biblioteka e qytetit po pasurohet me tituj dhe libra të rinj gjë e cila do të ndikojë edhe në shtimin e numrit të lexuesve lipjanas.



Komuna e Lipjanit ka njoftuar qytetarët se QKMF Lipjan është furnizuar me teste rapide për SarsCov- 2 nga Ministria Shëndetësisë dhe ka filluar testimi në QKMF



Vazhdon faza e dytë e shtigjeve të ecjes



Kryetari Ahmeti: "Një hapësirë e tillë i ka munguar Lipjanit"


Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka parë nga afër punimet që janë duke u zhvilluar në rregullimin e shtigjeve të ecjes rreth shtratit të lumit Sitnica.

Gjatë kësaj vizite Kryetari Ahmeti tha se, ky projekt i cili është duke u implementuar është një ndër investimet më të mëdhaja dhe një ndër investimet më të mirëpritura që ka Lipjani.

"Kjo është faza e dytë e projektit që kemi realizuar vitin që lam pas, për ndërtimin e shtigjeve të ecjes dhe shtegut të bicikletave në qytetin e Lipjanit dhe i cili është mirëpritur nga qytetarët lipjanas. I ka munguar Lipjanit një hapësirë e tillë dhe është një ndër porojektet që është vlerësuar shumë nga qytetarët dhe me gjerë" është shprehur kryetari Ahmeti.



Po punohet në rrugën katër korsi në Lipjan





Së shpejti fillon ndërtimi i urës mbi lumin sitnica në Rufc të Ri dhe asfaltimi i rrugës “Marie Shllaku”.

Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me Ministrin e Infrastrukturës, Arban Abrashi kanë nënshkruar memorandum mirëkuptimi për financimin e disa projekteve në Lipjan.



Në këtë memorandum parashihet që të bëhet ndërtimi i urës mbi lumin sitnica në Rufc të Ri poashtu këtë vit do të bëhet dhe asfaltimi i rrugës “Marie Shllaku”.

Kryetari Ahmeti u shpreh se këto projekte janë të mirëseardhura për qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Kryetari Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti ka marr pjesë në një takim që është organizuar nga OJQ YAHR me të rinjtë e Komunës së Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT



Kryetari Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti ka marr pjesë në një takim që është organizuar nga OJQ YAHR me të rinjtë e Komunës së Lipjanit.

Gjatë këtij takimi shumë të rinjë patën mundësin të bëjnë pyetje Kryetarit Ahmeti ku njëherit dhe është përgjigjur.

Kryetari Ahmeti po ashtu inkurajoi të rinjtë që të jenë më aktiv në jetën shoqërore.



ARTA SHAHINI NDEROHET ME MIRËNJOHJE PËR MËSUESEN MË TË DALLUAR



Drejtoresha Arsimit në Komunën e Lipjanit, Elmaze Behluli ka ndar mirënjohje për mësime dhënëse më të dalluar nga Shkolla Fillore “Vëllezërit Frashëri”, Arta Shahini.

Drejtoresha Behluli ka falënderuar mësime dhënëse Shahini për kontributin e dhënë në arsim.

Mësime dhënëseja Arta Shahini u shpreh mirënjohës ndaj Komunës së Lipjanit për këtë çmim, për të cilin tha se i jep fuqi për të vazhduar edhe më tutje me përkushtim në misionin e shenjtë të edukimit të brezit të ri.

KRYETARI AHMETI E DREJTORESHA BEHLULI TAKOJNË DREJTORIN E SH.F.M.U “SHTJEFËN GJEÇOVI” , NË JANJEVË GAFURR BYTYQI ME RASTIN E PENSIONIMIT



Kryetari i Komunës Imri Ahmeti së bashku me Elmaze Behluli Drejtoreshë e DKA-së kanë takuar drejtorin e sh.f.m.u “Shtjefën Gjeçovi” , në Janjevë Gafurr Bytyqi me rastin e daljes në pension.

Kryetari Ahmeti i ka uruar drejtorit Gafurr Bytyqi pensionim të rehatshëm e të shëndetshëm, duke besuar që edhe më tutje të kontribuoj në arsim përmes vargjeve dhe poezive të shumta.

"KROMOZOMI IM VETËM SE MA SHTON BUKURINË"

Drejtoresha e Arsimit, Elmaze Behluli së bashku me drejtoreshën e Shëndetësisë, Merita Bytyqi ishin pjesë e aktivitetit të organizuar nga OJQ "HOPE" në Lipjan, aktivitet ky i realizuar për fëmijët me Sindromin Down me moton "Kromozomi im vetëm se ma shton bukurinë".



Drejtoresha Arsimit Elmaze Behluli ka pritur në takim përfaqësuesit World Vision ku u diskutua kryesisht mbi mundësitë për thellimin e bashkëpunimit nëpërmjet planeve për bashkëfinancim në 17 shkollat e Komunës së Lipjanit në kuadër të programeve të World Vision.

Në këtë takim po ashtu u potencua për vazhdimin e implementimit të projekteve bashkëfinancuese që kanë filluar vitin e kaluar me pajisjen e shkollave me kabinetet e kompjuterëve dhe sigurinë e tyre, shpërndarjen e pakove ushqimore dhe tableteve për familjet dhe fëmijet më në nevojë si mbështetje për nevojat e tyre emergjente të krijuara nga situata me pandeminë Covid-19.

KRYETARI AHMETI TAKON GRATË LIPJANASE QË JANË TË PËRFSHIRA NË BIZNESE TË NDRYSHME



Kryetari i komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti me rastin e festës së 8 marsit ka takuar gratë në biznese të Komunës së Lipjanit, ku kanë diskutuar për sfidat e tyre në të bërit biznes përkundër përballjes me Covid-19





Mbahet mbledhja e rregulltë e KKSB-së

Është mbajtur mbledhja e rregulltë e KKSB-së ku nënkryetari Fauz Xhemajli tha se gjendja e sigurisë në Komunën e Lipjanit aktualisht është e mirë dhe se duhet angazhim maksimal i të gjithëve që kjo situatë e qetë të vazhdoj.

Gjatë këtij takimi është bërë diskutimi dhe aprovimi i raportit të punës së KKSB-së për vitin 2020, diskutim, plotësimi dhe aprovimi i planit të punës së KKSB-së për vitin 2021.

Përfaqësues nga Policia Kosovës duke treguar statistikën e fundit për gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Lipjanit, gjendja e sigurisë është vlerësuar po ashtu e qetë.

Lansohet platforma **online** <https://lipjangis.com>



Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me të riun nga Lipjani, Jetmir Bytyqi sot kanë lansuar platformen online <https://lipjangis.com>, për qytetin e Lipjanit.

Me këtë rast Kryetari Ahmeti ka përgëzuar të riun Bytyqi për punën që ka bërë në realizimin e kësaj platforme e cila posedon një numër të madh të të dhënave hapësinore, që për qëllim kanë informimin e saktë dhe të shpejt të qytetarëve.

Në këtë platformë përfshihen 941h, po ashtu është digjitalizuar shfrytëzimi i tokës në 19 kategori, në 3301 objekte duke i përfshirë rrugët, lumenjtë dhe mbi 200 lokacione të interesit, ku secili lokacion përmban një data bazë në vete, si: foto, përshkrim, adresa, kontakte etj.

Platforma online LipjaniGis me të dhënat gjeohapsinore ku përfshihen zonën urbane, zonën kadastrale në Lipjan, lokacioni është termi kryesor. Manipulimi me shtresa, fleksibiliteti me shkallë të hartës, baza e të dhënave, qasja më e lehtë nga të gjithë, saktësia, thjeshtësia maksimale, janë vetëm disa nga përparësitë që e karakterizojnë platformën WebGIS.

KRYETARI AHMETI KA PRITUR PËRFAQËSUESIT E PROJEKTIT DEMOS



Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti ka pritur sot në takim përfaqësuesen e Zyrës Zvicrane për zhvillim dhe bashkëpunim Katharina Stocker si dhe menaxherët e projektit DEMOS, Saranda Cana dhe Ertan Munoglu me të cilët ka diskutuar për projektet e realizuara në bashkëpunim me komunën dhe projektin Demos.



KRYETARI IMRI AHMETI KA PRANUAR PROJEKTET NGA BANKA BOTËRORE PËR RENOVIMIN E 7 NDËRTESAVE NË QYTETIN E LIPJANIT



Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti në një takim me ekipin e projektit të Bankës Botërore të udhëhequr nga Lumnije Gashi Shabani, sot në zyrën e tij ka pranuar projektet për renovimin e 7-të ndërtesave të përzgjedhura në kuadër të fazës së dytë të projektit të Bankës Botërore dhe Agjencionit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë i quajtur “krijimi i shoqatave të banorëve të ndërtesave të banimit në bashkëpronësi”.

Me këtë rast, Kryetari Imri Ahmeti ka falenderuar Bankën Botërore dhe Agjencionin për Eficiencë të energjisë që kanë mundësuar realizimin e këtyre projekteve.

QMF MAGURË DHE AMF SLLOVI ME NJË PAMJE TË RE



Drejtoresha e Shëndetësisë në Komunën e Lipjanit, Dr. Merita Bytyqi ka pritur në takim Laurent Torche Zëvendësdrejtor i zyrës Zvicrane për Bashkëpunim, ku kanë vizituar QMF Magure dhe AMF në Sllovi pas renovimeve të bëra në kudër të projektit të AQH-së.

Drejtoresha Bytyqi në emër të Kryetarit Imri Ahmeti dhe Komunës së Lipjanit ka falenderuar Laurent Torche për bashkëpunimin e treguar dhe ka theksuar se projekte të tilla janë të mirëseardhura për Komunën e Lipjanit.

Zëvendësdrejtori Toche u shpreh i lumtur me punimet që janë bërë në QMF dhe AMF duke theksuar se do të vazhdohet edhe më tutje me renovime të tilla.

MBAHET SEANCA E RADHËS E KUVENDIT KOMUNAL NË LIPJAN

Kuvendi Komunal i Lipjanit nën udhëheqjen e Kryesuesit Daut Azemi ka zhvilluar punimet e mbledhjes së radhës mbledhje në të cilën u aprovuan pika e rendit të ditës të cilat ishin propozuar për shqyrtim gjatë kësaj seance.

Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ka prezantuar raportin vjetor Janar-Dhjetor 2020 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale ku është theksuar se viti që lamë pas ishte vit jashtëzakonisht sfidues dhe me situatat që na kanë përcjellur mundë të cilësohet si vit i pandemisë COVID 19. Kryetari Ahmeti është përgjigjur në të gjitha pyetjet dhe temat e ngritura nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Janë miratuar këto propozim vendime: Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2019 dhe 2020 më vitin 2021, raporti vjetor Janar-Dhjetor 2020 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale, propozim vendim për caktimin e lokacioneve për vendosjen e shtatoreve për dëshmorët dhe veprimtarin e Kombit, propozim rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për varresat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre 15NR.011-71878 e datës 27.11.2028, propozim vendim për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit, propozim rregullore mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, propozim vendim për formimin e komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit, propozim vendim për zëvendësimin e Kryesuesit të Komisionit të Ankesave.



Po ashtu gjatë kësaj seance nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është dhënë raport rreth situatës me Covid-19 në Komunën e Lipjanit, dhe nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, po ashtu është dhënë raport për dëmet e shkaktuara nga vërshimet në Komunën e Lipjanit.



KRYETARI I KOMUNËS SË LIPJANIT, IMRI AHMETI, ME BASHKËPUNËTORË TË TIJ, KA BËRË HOMAZHE DHE KA VËNË KURORË LULESH PRANË LAPIDARIT TË HEROIT TË KOMBIT, ISMET ASLLANI, ME RASTIN PËRVJETORIT TË RËNIES SË TIJ.



BULETINI MUJOR



RR. SHQIPËRIA NR: 28 14000 LIPJAN, KOSOVË

TEL: 038 200 41 508

THIRR PA PAGESË 0 800 14 000

EMAIL: INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET